



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 3496/prot.
20

Tiranë, më 09.10.2024

URDHËR

Nr. 157, Datë 09.10.2024

PËR

MIRATIMIN E PERIUdhËS SË APLIKIMEVE ME FORMULARIN A1Z PËR MSH 2024

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 661, datë 01.12.2023, “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 15, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe zhvillimin e sesionit të dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2024 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 13.03.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin A1Z, për MSH 2024, **në datën 04 Tetor 2024, ora 08.00 – 16.00.**
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Aurora Balliu

